



Newsletter, KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.8 Gusht 2019

Index:

Aktivitate	2
Deklaratë	3
Aktivitate	4
Poster sensibilizues	5

KOMISIONERI GAJDA REAGON PËR SHPREHJEN DISKRIMINUESE TË PARLAMENTARIT QË CËNOJNË DINJITETIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda përmes një deklarate për shtyp reagoi për shprehjen diskriminuese të një të zgjedhuri në Kuvendin e Shqipërisë, që cënon dinjitetin e personave me sindromën Down.

Në deklaratë Komisioneri Dr. Gajda u shpreh se:

Po ndjek me shqetësim përdorimin e gjuhës diskriminuese dhe denigruese kundrejt aftësisë së kufizuar nga funksionarë të lartë publik por edhe persona të veçantë, me status të ish-parlamentarit.

Përdorimi i gjuhës së diskriminuese në rrjetet sociale është e papranueshme dhe për këtë arsye Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) do të nisë çështje kryesisht (ex-officio), siç e parashikon ligji, për të ndrequr situata që cënojnë dinjitetin e njeriut.

Ndërkohë, KMD pret një reagim të menjëhershëm të personave publikë që kanë përdorur gjuhë diskriminuese duke kërkuar falje publike.

Diskriminimi, Gajda: Shkelje e rëndë, gjoba deri në 6 milionë lekë



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda, ka deklaruar në rubrikën “Opinion”, në News24, se po bëhet një punë e madhe për ndërgjegjësimin e subjekteve lidhur me diskriminimin, duke e cilësuar këtë një ndër shkeljet më të rënda që mund t’i bëhet njeriut. Në studion e News 24, Gajda zbuloi dhe gjobat që iu vihen subjekteve për këtë shkelje, që kapnin vlerat e 100-600 mijë lekë të rinj.


“Ne synojmë rritje të bashkëpunimit me organizatat. Vendosim gjoba 100-600 mijë lekë të rinj. Vendimet e komisionerit po përdoren së fundi nëpër gjykata. Kjo i ka dhënë ankimesve të drejtë për shpërblime të majme. Duam që subjektet të ndërgjegjësohen për diskriminimin, sepse është një nga shkeljet më të rënda që mund t’i bëhet një njeriu”, tha Gajda.

Hetimi për dy radikalët që bënin thirrje kundër Maqedonisë e Kosovës, po rritet gjuha e urrejtjes online?

Kemi një handikap të madh, sepse ende nuk e vëzhgojmë gjuhën e urrejtjes online, që ka shumë. Ky është problem, sepse manifeston shoqërinë. Jemi shumë mbrapa, sepse shumë vende evropiane kanë filluar të monitorojnë gjuhën e urrejtjes online. Është shumë e rëndë, sepse së pari prek aspektin fetar, dhe e dyta, gjuha e përdorur është shumë ekstreme.

Në këtë rast, ne kemi dhe dispozita në kodin penal. Ajo që zyra e komisionerit ka bërë është se u jemi drejtuar me shkresë të dyja prokurorive, që t’i shqyrtojnë me seriozitet dhe vëmendje këto çështje. Sepse nga deklarata të tilla, mund të kalohet në veprime dhe njerëzit të përfundojnë në tragjedi.

Ngjarja në Porto Palermo, në shumë vende ka shumë diferencime në çmime, a janë këto sjellje diskriminuese? Sigurisht që janë. Janë fenomene që ndodhin, një diferencim për shqiptarët dhe të huajt.



Deklaratë e KMD mbi dy rastet e gjuhës së urrejtjes online ndaj bashkatdhetarëve



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda përmes një deklarate për shtyp reagoi për gjuhës së urrejtjes online ndaj bashkatdhetarëve.

Në deklaratë Komisioneri Dr. Gajda u shpreh se:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda përshëndet veprimin e Policisë së Shtetit për të hetuar e referuar në prokurori dy rastet e gjuhës së urrejtjes online për shkak të besimit fetar të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut dhe Kosovë, të bëra publike në media.

Harmonia dhe toleranca ndërmjet besimeve

fetare të kultivuar në shekuj është gurthemeli i fuqisë së popullit tonë, që duhet ruajtur me krenari dhe në respekt të ligjeve.

Gjuha e urrejtjes në vendin tonë po shënon rritje shqetësuese në rrjetet sociale dhe KMD synon të bashkëpunojë me institucionet për të parandaluar dhe ndrequr këto shprehje diskriminuese që çënojnë dinjitetin e njeriut.

Më herët, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dënuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes në incidente të përsëritura në stadione për shkak të përkatësisë etnike dhe racore, të fytyrës së grupeve vulnerabël si rom dhe egjiptian, si dhe përfaqësues të komunitetit LGBTI në mediat sociale.



KMD takim informues me komunitetin rom dhe egjiptian në Noveselë, Vlorë



Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvilloi një takim informues me komunitetin rom dhe egjiptian në Noveselë, Vlorë.

Përfaqësuesit e komuniteteve ngritën shqetësime serioze mbi furnizimin me ujë të pijshëm, energjia elektrike, çështje të legalizimit të banesave dhe situatat e strehimit.

Stafi i KMD informoi përfaqësuesit e komunitetit rom dhe egjiptian të Novoselës për mundësitë e adresimit të çështjeve, sipas rasteve të diskriminimit përmes ankesave apo zhvillimin të takimeve me institucionet në nivel vendor dhe qendror.

Ky takim u lehtësua nga programi ROMACTED.





TONI MORRISON

Nobeliste për Letërsi

"Gjuha shtypëse (imponuese, stigmatizuese) është më shumë sesa përfaqësuese e dhunës; ajo është dhunë; është më shumë se sa përfaqësuese e kufizimit të dijes; ajo është kufizim i dijes. Pavarësisht nëse është gjuha e errët e Shtetit apo gjuha e shtirur e mediave dritëshkurtër; nëse është gjuha krenare por e ngurtë e akademisë ose gjuha konformiste e shkencës; nëse është gjuha e ligë e ligjit pa etikë, apo gjuha e krijuar për shfytërimin e minorancave, duke fshehur një plaçkitje raciste në anën e saj letrare - ajo duhet të refuzohet, ndryshohet dhe të ekspozohet "

www.kmd.al

DRITË MBI KMD

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi siguron mbrojtje efektive nga çdo lloj forme diskriminimi

Emri: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Karakteristikat: Lufton Diskriminimin

Misioni: Promovon barazinë

Besimi: Tek ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Fuqia: Njerëzit

Dobësia: Koha e pamjaftueshme

Çështje të trajtuara: 287

Viti: 2018

Ankesa: 197

www.kmd.al



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Kreu i KMD:

Z. Robert Gajda

Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është institucion i pavarur i Republikës së Shqipërisë. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Ai mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), e cila ka personelin dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur Komisionerin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010.

Për informacione të mëtejshme mbi aktivitetet:
www.kmd.al

Zyra qendrore e KMD

Rr: Rruga e Durrësit (Ish Ministria e Mjedisit)
Tirana, Albania
Zip Code: 1001
E-mail: info@kmd.al
Tel:
Komisioneri: + 355 4 243 1077
Ankesa: + 355 4 243 1078

Zyra rajonale:

Shkodër: Pranë Bashkisë Shkodër, Rr.13 Dhjetori, Nr.1
Zip Code: 4001
Tel: + 355 4 243 1078

Korçë: Pranë Bashkisë Korçë Rr:28 Nentori Nr.1
Zip Code: 7001
Tel: + 355 4 243 1078